

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR THE PREVENTION OF CORRUPTION

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 02.11.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-2895/22, për zyrtaren e lartë znj. Shqipe Ibraj-Mala, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi, për zyrtaren e lartë znj. Shqipe Ibraj-Mala, Drejtor i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese - MKP, Institucioni i Avokatit të Popullit (në vijim: Drejtor i MKP të IAP-së), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), ku janë ngritur pretendime se: *'Ekziston dyshimi i arsyeshëm për konfliktin e interesit, se zyrtarët nga Institucioni i Avokatit të Popullit kanë ndikuar në avancimin e interesave personale duke përdorur pozitat zyrtare. Ashtu siç u cek me lart për shkak se AAC nuk ju ka lejuar e drejta e dëgjimit, në raport përfundimtar ka pretendime të cilat avokatit të popullit i kanë shfrytëzuar për nxjerrjen e pretendimeve mbi diskriminim. Sipas informacioneve që kemi znj. L.I. është familjare me zyrtaren e lartë në Institucionin e Avokatit të Popullit, Shqipe Ibraj-Mala e cila në institucionin të Avokatit të Popullit ka mbajtur dhe mban pozita të larta drejtuese si zëvendës e Avokatit të Popullit dhe pozita tjera drejtuese. Kërkojmë nga Agjencinë Kundër Korrupsionit që të trajtoj konfliktin e interesit sipas ligjit LIGJI Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Neni 7 Identifikimi i konfliktit të interesit dhe burimi i informatave'.*

Rasti në fjalë i referohet Raportit të Avokatit të Popullit nr. A.nr. 474/2021, A.D. dhe të tjerët, përkitazi me pretendimet e ankuesve për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit si anëtarë në Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-1/3587/22, duke e njoftuar zyrtaren e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Ndërsa, në drejtim të sqarimit të kësaj situatë, është realizuar një takim në Agjenci me znj. Shqipe Ibraj-Mala, ku janë diskutuar dhe ballafaquar të gjitha informacionet në dispozicion. Në takim pala ka deklaruar prerazi se, *nuk ka qenë pjesë e asnjë vendimmarrje apo procesi të përpilimit të raportit të IAP-së në fjalë, dhe ka përjashtuar çfarëdo përfshirje gjatë zhvillimit të hetimeve, diskutimeve apo shqyrtimeve paraprake të këtij rasti.*

Më pas, me qëllim të sqarimit të gjithanshëm të këtij rasti, Agjencia ka kërkuar informacion shtesë nga Institucioni i Avokatit të Popullit (në vijim: IAP), dhe në përgjigjen e Avokatit të Popullit nr. 130/2021, të datës 21.10.2022, thuhet se: “[...]...zgj. Shqipe Ibraj-Mala, nuk ka qenë e përfshirë në asnjë fazë të zhvillimit të hetimeve si dhe të diskutimeve apo shqyrtimeve paraprake të këtij rasti. E njëjta, nuk ka asnjë përgjegjësi zyrtare të ngarkuar në procedimin e rastit dhe as të ndonjë veprimi tjetër i cili është ndërmarrë për këtë rast. Për më tepër, rasti A.nr.474/2021 është punuar nga Departamenti për Mbrojtjen nga Diskriminimi në IAP, i mbikëqyrur dhe aprovuar nga unë, si Avokat i Popullit ndërsa, funksioni i znj. Shqipe Ibraj-Mala në Institucionin e Avokatit Popullit nuk ka të bëjë me fushëveprimin e departamentit për mbrojtje nga diskriminimi dhe nuk ka qenë e përfshirë në asnjë fazë të vendimmarrjes në rastin për të cilin ju i referoheni[...]”.

Në këtë mënyrë, me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është përcaktuar se:

“1. Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”

...lidhur me dispozitën e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e definojnë nocionin vendimmarrje si:

“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik”.

Në rastin konkret dhe në kuptim të dispozitave të sipërcituara, fakti që znj. Shqipe Ibraj-Mala, e ka person të afërm (motër) znj. L.I., njëra nga ankueset në rastin A.nr. 474/2021, A.D. dhe të tjerët, Agjencia vlerëson se kjo situatë, edhe pse mund të perceptohet, nuk paraqet *a priori* konflikt të interesit, pasi që konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes, ndërsa znj. Shqipe Ibraj-Mala nuk është gjetur të jetë përfshirë në asnjë fazë të vendimmarrjes (përfshirë çastet paraprake të vendimmarrjes), nuk është përfshirë, siç është konstatuar edhe në njoftimin e Avokatit të Popullit, *‘në asnjë fazë të zhvillimit të hetimeve si dhe të diskutimeve apo shqyrtimeve*

paraprake të këtij rasti' dhe se 'funksioni i znj. Shqipe Ibraj-Mala në Institucionin e Avokatit Popullit nuk ka të bëjë me fushëveprimin e departamentit për mbrojtje nga diskriminimi dhe nuk ka qenë e përfshirë në asnjë fazë të vendimmarrjes në rastin në fjalë'.


Gjithashtu, në këtë rast, nuk ka njoftim me shkrim nga IAP, e as nuk është gjetur ndonjë provë që në rastin konkret znj. Shqipe Ibraj-Mala të ketë ushtruar ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime, në ndryshimin e vullnetit të ndonjë zyrtari gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit publik, konform nenit 16 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Andaj, në bazë të vlerësimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas pretendimeve të raportuesit të rastit dhe vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.


Yll Buleshka
Drejtore i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit